



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:055488

Datë: 24.04.2024

Numri i dokumentit: 05612069

Ac.nr.4543/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, kolegji në përbërje nga gjyqtari Besnik Bislimaj– kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve Faton Ademi dhe Hidajete Gashi Alaj, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të paditëses M. S. nga Prishtina, të cilën e përfaqëson avokati F. C. M., nga Prishtina, rr. “S. Sh.”, 30/A, nr.5, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbëresh” me seli në Prishtinë, për kompensimin e dëmit material dhe jo material, duke vendosur sipas ankesave të paditëses dhe të paditurës, të paraqitura kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2465/2020 datë 07.04.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 22.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. PJESËRISHT aprovohet si e bazuar ankesa e paditëses M. S. nga Prishtina dhe refuzohet në tërësi si e pa bazuar ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë dhe, NDRYSHOHET pika I dhe II e aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2465/2020 datë 07.04.2021, sa i përket dëmit jo material dhe material për ushqim të përforcuar dhe çështja tani gjykohet si në vijim: DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, që në emër të dëmit jo material t’ia kompensoj paditëses M. S. nga Prishtina, shumat si në vijim: për dhimbjet e përjetuara fizike shumë prej 1,400.00 euro, për frikë të përjetuar shumë prej 1,100.00 euro; për ushqim të përforcuar, shumë prej 150.00 euro. Pjesa tjetër e kërkesë padisë së paditësit, përtej shumave të gjykuara e deri në shumat e kërkuara për këto kategori të dëmit, refuzohen si të pa bazuar.

II. aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.2465/2020 datë 07.04.2021, në pikën II në pjesën refuzuese sa i përket rehabilitimit klimatik si dhe pika III, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2465/2020 datë 07.04.2021, ka vendosur:

- I.** Pjesërisht miratohet kërkesë-padia e paditëses, M. S., nga Prishtina, ashtu që Detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jo material paditëses të lartë përmendur t’ia kompensojë shumën prej 1,750.00€, (njëmijë e shtatëqindpesëdhjetë euro), me kamatën përkatëse ligjore të cilën e paguajnë Bankat komerciale në Kosovë për mjetet e deponuara mbi një vit, pa destinim të caktuar, e cila fillon të rrjedhë nga data e nxjerrjes së këtij aktgjykimi, deri në pagimin definitiv, e krejt këto në afatin prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së Aktgjykimit, e nën kërcënim të përbarimit dhe atë për këto kritere të dëmit:
 - për dhimbjet e përjetuara fizike, shumën prej 900.00€,
 - për frikën e përjetuar, shumën prej 800,00€,
 - për ushqim të përforcuar, shumën prej 50,00€,

- II.** Refuzohet si e pabazuar pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave nga pika një e dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe atë, në emër të kompensimit për dhimbjet fizike, shumën prej 1,200.00€, në emër të kompensimit për frikë, shumën prej 700.00€, në emër të kompensimit për ushqimin e përforcuar, shumën prej 150.00€ si dhe në emër të rehabilitimit klimaterik, shumën prej 140.00€.

- III.** Detyrohet e paditura, që në emër të shpenzimeve procedurale, paditëses të ia paguaj shumën prej 1,221.50€, në afatin prej 15 ditëve nga dita e marrjes së këtij Aktgjykimi, e nën kërcënim të përbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, e paditura, ka parashtruar ankesë, për shkak të: shkeljeve të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështja të kthehet në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu, kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, paditësja ka paraqitur ankesë për shkak të: për shkak të: shkeljeve të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa e paditëses në tërësi si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ta aprovoj kërkesë padinë e paditëses në tërësi si të bazuar.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-ankesa e paditëses është pjesërisht e bazuar.

-ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria” është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja M. S. nga Prishtina, me datë 23.09.2011, në gjykatën e shkallës së parë ka parashtruar padi kundër të paditurës, Kompania e Sigurimeve “Siguria” me seli në Prishtinë, për kompensim të dëmit material dhe jo material, të cilën kërkesë paditësit e ka precizuar me parashtresën e dorëzuar me shkrim të datës 29.09.2016, konkretisht si në të njëjtën parashtresë.

Gjykata e shkallës së parë, duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesore, pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 2116/2011 datë 17.10.2016, me të cilin ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpapia e paditëses, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjor, e paditura, ka parashtruar ankesë, për shkak të: shkeljeve të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit që të aprovoj ankesën e të paditurës si të bazuar dhe ta anuloj aktgjykimin e shkallës së parë dhe çështja të kthehet në ri procedurë dhe ri vendosje.

Gjithashtu, kundër këtij aktgjykimi, në afatin e paraparë ligjorë, paditësja ka paraqitur ankesë për shkak të: për shkak të: shkeljeve të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa e paditëses në tërësi si e bazuar, ashtu që të ndryshohet aktgjykimi i ankimuar dhe ta aprovoj kërkesë padinë e paditëses në tërësi si të bazuar.

Gjykata e Apelit me aktvendimin AC.nr. 481/2017 të datës 17.10.2016, ka aprovuar si të bazuara ankesat e palëve ndërgjyqëse dhe e ka prishur aktgjykimin e ankimuar C.nr. 2116/2011 datë 17.10.2016 dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim dhe ri vendosje.

Gjykata e shkallës së parë, në ri procedurë, ka mbajtur shqyrtimin kryesore, pas deklarimit të palëve ndërgjyqëse, administrimit të provave, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr. 2465/2020 datë 07.04.2021, me të cilin ka vendosur që të aprovohet pjesërisht kërkesëpapia e paditëses, duke vendosur me saktësisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ndër të tjera ka theksuar se: Nga Raporti i Aksidentit nr. nr.3..., dt.12.11.2010, Gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se më datën dt. 12.11.2010 në rrugën “Prishtinë – Fushë Kosovë”, në udhëkryqin të BBC, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, në mes të automjetit kombi, të markës “VW”, me targa ...-KS-...1, të cilin e drejtonte V. A. dhe automjetit të markës “F..”, me targa-KS-6..., të cilin e drejtonte M. S.. Deri të aksidenti ka ardhur derisa drejtuesi i automjetit të markës “VW”, me targa ...-KS-...1, i cili po qarkullonte në rrugën - udhëkryqin të BBC, në rrugën “Prishtinë – Fushë Kosovë”, hyn në udhëkryq semafor pa i lejuar të kalojnë automjetet me përparësi kalimi (pasi që ka funksionuar vetëm drita e verdhe në semafor) duke mos respektuar rregullat e përgjithshme të komunikacionit, gjegjësisht duke mos respektuar përparësinë e kalimit, e godet automjetin e markës “F...”, me targa ...-KS-..., në pjesën e pare të majtë i cili po qarkullonte rrugës kryesore duke i shkaktuar kështu dëme materiale këtij automjeti si dhe lëndime trupore drejtueses se tij, tani paditëse M.. S.. Automjeti me të cilin është shkaktuar aksidenti, në atë moment ka qenë i siguruar te e paditura.

Më tej ka theksuar se: Ekspertiza e ekspertit të komunikacionit datë 13.02.2021, e punuar nga B. A. ingjnier i komunikacionit, u vërtetua fakti se me datën 12.11.2010 rreth orës 7:40, në magjistralen Prishtinë-Fushë Kosovë, pikërisht te udhëkryqi i BBC në Zonën Industriale në Fushë Kosovë, ku rruga ka qene e shtruar me asfalt, rruge me dy drejtime, tre shirita për drejtim te lëvizjes se automjeteve të ndare fizikisht, me kufizim të shpejtësisë 50km/h, me dukshmëri të mire në ditën dhe momentin kritik, ka ndodhur aksidenti i komunikacionit dhe atë në mes të drejtueses se automjetit “A”, automjeti i markës “VW 3B”, me targa të regjistrimitKS-.... znj. V. A., dhe paditëses si drejtuese e automjetit “B” automjeti i markës “F. P.”, me targa të regjistrimit 492-KS-657, znj. M. S.. Sipas ekspertizës se komunikacionit, të cilës gjykata ia fali besimin, deri të aksidenti ka ardhur kur drejtuesja e automjetit “A” ka filluar qe nga rruga dytësore të kyçet për në rrugën kryesore në drejtim të Prishtinës (kyçje në të majtë) pa e verifikuar paraprakisht komunikacionin në atë pjesë të rrugës, ku në momentin kritik drejtuesja e automjetit “B” ka qene duke lëvizur në rrugën magjistrale në shiritin e djathte nga Prishtina në drejtim të Fushë Kosovës dhe me të arritur tek udhëkryqi i BBC-se, ku ky udhëkryq ka qene i rregulluar me sinjalizim ndriçues- mirëpo në momentin e aksidentit sinjalizuesit ndriçues nuk kane qene duke funksionuar me drita të verdha vezulluese), ku drejtuesja e automjetit “B”, në pa mundësi qe të ndal automjetin e saj me pjesën e përparme të anës se djathte ndeshet me automjetin “B”, në pjesën e prapme. Pra drejtuesja e automjetit “A” me automjetin e saj ka qene duke u kyçur në rrugën dytësore për në rrugën kryesore në drejtim të Prishtinës, ndërsa drejtuesja e automjetit “B”, me automjetin e saj ka qene duke lëvizur në rrugën magjistrale nga drejtimi Fushë Kosovës në shiritin e djathtë.

Më tej ka shtuar se: Bazuar në konstatimet dhe vlerësimet e ekspertit të komunikacioni, gjykata vlerëson se në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme është sqaruar mënyra e ndodhjes, shkaktaret, e rrjedhimisht përgjegjësit për shkaktimin e aksidentit të datës 12.11.2010, të shkaktuar rreth orës 7:40, në magjistralen Prishtinë-Fushë Kosovë, pikërisht te udhëkryqi i BBC në Zonën Industriale në Fushë Kosovë. Pra tanimë është vërtetuar se drejtuesja e automjetit “A”, i siguruari i të paditurës është përgjegjëse për shkaktimin e aksidentit, ndërsa drejtuesi i automjetit “B”, këtu paditësja nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidenti, pra me këtë edhe u vërtetu baza juridike e kërkesëpadisë.

Më tej ka shtuar se: Gjykata për të caktuar lartësinë e dëmit material dhe jo material të pësuar të paditëses (me rastin e aksidentit lëndor të ndodhur me dt. 17.07.2012), qëndrimin e saj e bazoj në ekspertizat mjeko-ligjore të Dr. V. B.– ortoped-traumatolog dhe Dr. N.. M.- psikiatër, kriteret dhe përmasat për caktimin e lartësisë së dëmeve materiale dhe jo materiale të cilat i aplikojnë kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë dhe praktikën gjyqësore. Nga ekspertiza mjekësore kemi konstatimin se natyra e lëndimeve trupore të paditëses është cilësuar si lëndime të lehta trupore, ndërsa sipas ekspertizës së ekspertit mjeko – ligjor, Dr. V. B. – ortoped-traumatolog, u vërtetua fakti se paditësja ka pasur dhimbje fizike- trupore dhe atë dhimbje të intensitetit posaçërisht të rëndë dhe të rëndë nuk ka pasur, dhimbje të intensitetit të mesëm ka pasur në kohëzgjatje prej 15 ditë, (çka dëshmohet në bazë të terapisë së urdhëruar, mbajtja e qafores si dhe kontrolla të shpeshta te ortopedi), dhimbje të intensitetit të ulët, në kohëzgjatje prej 2 muajsh herë pas here.

Më tej ka shtuar se: Sa i përket kërkesës tjetër të paditëses që i referohet frikës së përjetuar, si pasojë e aksidentit lëndor, Gjykata qëndrimin e vet e bazoj në ekspertizën nga lëmia e psikiatrisë Dr. N. M.– psikiatër, i cili në rastin konkret ka vërtetuar faktin se paditësja ka përjetuar frikë primare e cila ka zgjatur disa sekonda, frikë sekondare e intensiteti të lartë, e cila ka zgjatur 24 orë, (e manifestuar me ankthe dhe gjendje të reagimit akut në stres të përjetuar me rikujtimin e ngjarjes

traumatike), frikë sekondare e intensitetit të ulët, e cila ka zgjatur rreth 2 muaj, (e manifestuar me rënie të disponimit dhe të vullnetit themelor, humbje të shpresës, vështirësive të adaptimit me kushtet e imobilizimit mjekësor, me qafore, me frikë dhe brengje për gjendjen shëndetësore në të ardhmen, mungesës së koncentrimin me çrregullim të gjumit, pasigurisë sidomos gjatë pjesëmarrjes në komunikacion).

Më tej ka shtuar se: Gjykata po ashtu mori parysh pretendimet e të paditurës, kur konteston kërkesëpadinë sa i përket bazës së kërkesëpadisë, ku tanime pas nxerrjes së ekspertizës së komunikacionit, e njejtë u vertetua si me lart, pra pretendimet e të paditurës i vlerësoi si të pa bazuara, ndërsa sa i përket lartësisë, të njejtat i vlerësoi si pjesërisht të bazuara, duke i dhënë të drejtë të njëjtës, pasi që shumat e kërkuara nga paditësjë, u vlerësuan si të larta, jo reale dhe jo në përputhje me praktikën gjyqësore si dhe ekspertizës nga lëmia mjekësore.

Më tej ka shtuar se: Lidhur me këkesat e aprovuara në shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sa i përket paditeses, gjykata vlerëson se të njejtat janë adekuate duke marr parasysh dënimin që i është shkaktuar paditëses dhe se lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit do t'i mundësojë të dëmtuarës – këtu paditëses satisfakcion që ajo të jetë në gjendje që deri në një masë të kompensojë të mirat jomateriale nga të cilat është privuar respektivisht atë shkallë të satisfakcionit të cilin ajo do ta kishte po qe se të njejtat nuk do t'i kishte humbur, e krejt kjo duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe nevojave të shtuara të ushqimisë, si dhe sa i përket frikës, gjykata me rastin e vendosjes mori parasysh edhe gjendjen e saj shëndetësore si shtatëzën në momentin e aksidentit. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jo material, si dhe në lidhje me shumën e kompensimit të këtij dëmi, mes tjerash gjykata ka pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirave dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe faktin se me të njëjtin të mos u shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e këtij kompensimi dhe qëllimin e tij shoqëror. Ndërsa sa i përket kërkesës së paditëses për kompensim dëmi, që ka të bëjë me rehabilitimi klimaterik, i cili sipas ekspertit të sipërcituar ka qenë i nevojshëm dy herë brenda vitit në kohëzgjatje prej 7 ditëve, por meqë i njëjti nuk u provua me ndonjë dëshmi përkatëse – faturë, nga e cila do vërtetohet fakti se paditësi ka pas (ka shpenzuar për) një tretman të tillë, gjykata këtë kërkesë e refuzoi si të pabazuar.

Më tej ka shtuar se: Ndërsa sa i përket pjesës refuzuese, respektivisht shumës mbi shumat e aprovuara, gjykata të njejtat i refuzoi, ngase konsideron se shumat e kërkuara mbi shumën e aprovuar nuk janë reale dhe se të njejtat nuk i përgjigjen shkallës së lëndimeve të pësuar nga ana e paditeses, gjë e cila vërtetohet edhe nga ekspertiza nga lëmia mjekësore si dhe nga ekspertiza e komunikacionit.

Për mënyrën e vendosjes, gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenin nenit 154, 178, 200 të LMD-së vitit 1978.

Në lidhje me kumatën është vendosur në kuptim të nenit 277 të LMD-së vërtit 1978.

Lidhur me vendimin mbi shpenzimet e procedurës është vendosur në kuptim të nenit 449 dhe 452.1 të LPK-se.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i Gjykatës së shkallës së parë është pjesërisht i drejtë dhe i ligjshëm në pjesën e ndryshuar, pasi që Aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, mirëpo e drejta materiale pjesërisht është zbatuar në mënyrë të gabuar. Gjithashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i kanë pretenduar palët ankuese me ankesë. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i Aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë dhe i ekzaminueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e Aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike i dispozitivit me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa qëndrueshme pretendimet ankimore të paditësit dhe të paditurës për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga provat që gjinden në shkresat e lëndës, të cilave dhe ja bali besimin e plotë edhe gjykatë së Apelit i rezulton e njëjta gjendje faktike e vërtetuar si ajo e gjykatës së shkallës së parë. Pasi që pa mëdyshje është vërtetuar se ekziston përgjegjësia e të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 12.11.2010, i cili dëm është shkaktuar me fajin e të siguarit të të paditurës, gjë që është vërtetuar nga ekspertiza e ekspertit të komunikacionit B. A., ing. Dipl, e datës 13.02.2021 si dhe nga provat tjera që gjinden nga shkresat e lëndës. Gjykata e shkallës së parë lartësinë e kërkesës e ka bazuar në mendimin e ekspertëve Dr. V. B. Ortoped – Traumatolog si dhe N. M., psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin e tyre profesional në lidhje me natyrën e lëndimeve trupore, dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar, si dhe nevojën për ushqim të përforcuar, e që gjykata e shkallës së parë në bazë të këtyre mendimeve ka përcaktuar edhe lartësinë e kompensimit të dëmit jo material të vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se është zbatuar në mënyrë të gabuar e drejta materiale nga gjykata e shkallës së parë në pjesën e ndryshuar të aktgjykimit të ankimuar kur janë gjykuar shumat për demin jo material ne emër të dhimbjeve fizike, frikës së përjetuar. Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar dispozitën e nenit 200 të LMD-së së vitit 1978 i cili ligje është aplikuar në këtë çështje kontestimore pasi që në kohën e shkaktimit të dëmit ka qenë në fuqi, pasi që për këtë kategori të dëmit shumat janë të tejet të ulta dhe nuk paraqesin kompensim realë për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri as me praktikën gjyqësore si dhe udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr. 41/2023 të datës 27.02.2023, Pasi që shumat e gjykuara si në aktgjykimin e ankimuar janë të ulëta dhe nuk u shkojnë përshtati synimeve dhe qëllimeve shoqërore për kompensimin e dëmit dhe as nuk janë në pajtueshmëri me praktikën gjyqësore, prandaj gjykata e shkallës së dytë e aprovoi pjesërisht ankesën e të paditëses, ndryshoi aktgjykimin e ankimuar pjesërisht për këto kategori të dëmit dhe gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke vlerësuar se shumat e aprovuara nga gjykata e shkallës së parë për format e kompensimit të dëmit jo material nuk bazohen në kriteret e zbatueshme për vlerësim, e as në praktikën gjyqësore të krijuar nga gjykatat e Kosovës për këto forma të shpërblimit të demit dhe as në natyrën dhe llojin e së mirës së dëmtuar.

Gjykata e Apelit, vlerëson se shumica e gjykuar si në dispozitivin nën I të aktgjykimit të shkallës së dytë janë adekuate me kriteret dhe qëllimin e përcaktuar me nenin 200 i LMD-së, sipas nenit 154.1 të LMD-së së vitit 1978, i cili ligje ka qenë në fuqi në kohën e shkakimit të aksidentit, e i cili parasheh që *“kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ia kompensoi, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*, kurse me dispozitën e nenit 195 par.1 i këtij ligji përcakton se *“Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur me këtë,....”*. Të nenit 200 të po këtij ligji i cili përcakton se *“Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor..., do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla...”*. ndërsa par. 2 përcakton *“Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial, si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata merr parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, e gjithashtu edhe për faktin se më të mos u shkoj përshtat synimeve që nuk janë të përshtatshme me natyrën e saj...”*. Andaj, gjykata e shkallës së parë është bazuar në dispozitat materialo-juridike të cilave u është referuar e në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë natyrën e lëndimeve, dhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë natyra dhe kohëzgjatja e dhimbjeve fizike, lloji, intensiteti dhe kohëzgjatja e frikës, rrethanat tjera, e sidomos moshën e paditëses si dhe praktika gjyqësore të cilat rezultojnë se shumica e gjykuara janë në përputhje me qëllimin shoqëror për kompensimin e dëmit. Gjykata ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për paditësit, duke shmangur qëllimet tjera materiale që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit.

Përveç kësaj Gjykata e Apelit e ndryshoj aktgjykimin e ankimuar edhe në pjesën e dëmit material sa i përket ushqimit të përforcuar, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë me mënyrën e vendosjes si në aktgjykimin e ankimuar në lidhje me lartësinë e kompensimit nuk ka arsyetuar në masë të duhur lartësinë e aprovuar. Andaj, në këtë kuptim gjykata e Apelit vlerëson se shumica e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në lidhje me dëmin material është adekuat dhe i përshtatet edhe natyrës së dëmit, pasi që ky lloj kompensimi i gjykuar sipas këtij aktgjykimi është në harmoni me rrethanat e tjera të krijuara si dhe me vlerësimin e ekspertëve mjekësor, të cilët kanë konstatuar se për paditësin ka qenë e nevojshme ushqimi i përforcuar për 15 ditë, dëme ky që është i mbështetur edhe në provat materiale që gjinden në shkresat e lëndës si dhe nevojat e paditëses të përcaktuara nga ekspertët e cekur si më lartë.

Gjykata e Apelit nuk i mori për bazë pretendimet e paditëses në lidhje me kërkesën për dëmin material për shpenzimet e terapisë fizikale, pasi që gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesë padinë e paditëses për këtë kategori të dëmit, pasi që i njëjti nuk ka ofruar prova për të vërtetuar faktin se ky dëmi është shkaktuar pasi që ky dëm duhet të argumentohet me prova material dhe se për gjykatën e Apelit nuk mjafton vetëm fakti i konstatimit të ekspertëve se paditësi ka nevojë për terapi fizikale, por është e domosdoshme të vërtetohet se paditësi ka realizuar terpinë fizikale dhe se i njëjti ka shpenzuar mjete monetare në shumën e kërkuar. Andaj në këtë kuptim, është përgjegjësi e paditësit të ofrojë prova në kuptim të nenit 7 të LPK-së, e që në rastin konkret i njëjti ka dështuar të ofrojë prova materiale për të vërtetuar kërkesë padinë e tij për këtë kategori të dëmit.

Gjykata e Apelit i vlerësoj pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me lëndimet e paditëses për shkak se i mungon lidhja kauzale në mes të lëndimeve dhe kohës së shkaktimit të aksidentit, por të njëjtat pretendime nuk u morën për bazë pasi gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë ka vërtetuar se paditësja në aksidentin e trafikut të datës 12.11.2010 ka pësuar lëndime trupore, pasi që është vërtetuar edhe nga ekspertiza e eksperteve mjeko ligjore të cilët kanë konstatuar se lëndimet e pësuar tek paditësja janë si pasojë e aksidentit dhe fakti se paditësja nuk ka qenë në vizitë tek mjeku apo në emergjencës ditën e aksidentit nuk nënkupton se e njëjta nuk ka qenë e lënduar në atë aksident, të njëjtës i kanë filluar dhimbjet dy ditë më vonë siç është konstatuar nga ekspertiza e cekur si më lartë, e gjithashtu edhe nga raportet mjekësore që janë administruar në këtë çështje kontestimore e që të njëjtat dhimbje paraqesin lidhje kauzale në mes të aksidentit dhe lëndimeve. Andaj, në rastin konkret nuk ka qenë kontestuese mes palëve që e njëjta ka qenë pjesëmarrëse në aksidentin e trafikut të cekur më lartë dhe fakti që e njëjta nuk ka qenë e evidentuar në raportin policorë të aksidentit si person e lënduar nuk nënkupton se e njëjta nuk ka qenë e lënduar, pasi që lëndimet e të njëjtës janë konstatuar nga raportet mjekësore si dhe ekspertizat mjekësore.

Sa i përket vendimit për kamatën e gjykuar nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që kamata e gjykuar është në pajtueshmëri të plotë me nenin 277 të LMD-së së vitit 1978 dhe se e njëjta do të filloj të rrjedhë nga dita e nxjerrjes së aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket vendimit për shpenzimet procedurale të gjykuara nga gjykata e shkallës së parë, edhe gjykata e Apelit e përkrah një vendim të tillë pasi që shpenzimet e aprovuara janë shpenzime në përputhshmëri të plotë me veprimet procedurale, e gjithashtu duke pas parasysh edhe suksesin e paditësit në procedurë dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit, nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të cekurat u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bazë të nenit 195.1 pika c) dhe e), të Ligjit nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4543/2021, me datën 22.04.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislímaj, d.v